

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Riciklimi i së kaluarës" në fushatën zgjedhore në Bosnje
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/ballkani/riciklimi-i-se-kaluares-ne-fushaten-zgjedhore-ne-bosnje-i1186028
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:09:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	897894604eec9c6bef55f3ddc4b397947713256b5b23cfed46702e4851a159d
TEKSTI	5284f263a721ea4242b6a9d0056cd4e324755b568c9ab62ee6d3d1c0acb30eba
PAMJA	63bddbdc805b5dfd9af6b525b1d48196601da355ea9b7c5b48ef578c14670669

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76c30f950212ae08aa787d1c5f6b938c3120fbf69c9dc1d70cab7c09f24c5495
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/76c30f950212ae08aa787d1c5f6b938c3120fbf69c9dc1d70cab7c09f24c5495>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Riciklimi i së kaluarës" në fushatën zgjedhore në Bosnje

Nga A2 CNN
28 Shtator 2026, 19:07 | Ballkani



Vdekja e kriminelit të dënuar të luftës, Ratko Mladiq, dhe varrimi i tij me nderime shtetërore në Beograd e futën Bosnje e Hercegovinën (BeH) në fushatën për zgjedhjet e përgjithshme të tetorit, në të cilën sërish flitet për ndarje, kërcënime, rrezikim dhe nevojën për mbrojtjen e popujve.

Fushata zgjedhore nisi më 4 shtator, ndërsa tri ditë më vonë, në Beograd, me nderime shtetërore u varros ish-komandanti i Ushtrisë së Republikës Srpska (RS), i cili vdiq në burgun e Hagës, ndërsa po vuante dënimin e përgjithshëm për gjenocid dhe krime të tjera lufte në BeH.

Në varrim mori pjesë edhe udhëheqja politike e entitetit RS, përfshirë disa kandidatë në zgjedhjet e këtij viti, ndërsa nga bashkësia ndërkombëtare dhe partitë politike në Federatën e BeH-së erdhën kritika, përcjell A2.

Edhe pse zyrtarisht nuk është kandidat në zgjedhje, Millorad Dodik u shndërrua në figurën qendrore të fushatës së Aleancës së Socialdemokratëve të Pavarur (SNSD), duke u shfaqur në tubimet parazgjedhore dhe në pllakatet krahas kandidatëve të partisë.

Ndaj paralajmërimeve nga bashkësia ndërkombëtare se glorifikimi i kriminelëve të dënuar të luftës është i papranueshëm, Dodik u përgjigj se "askush nuk do t'i tregojë popullit serb për kë duhet të mbajë zi", ndërsa vazhdoi edhe me retorikën për nevojën e shkëputjes së entitetit RS.

Në një nga tubimet e para parazgjedhore, Dodik tha se po punohet që "të mos ekzistojë kufiri mes Serbisë dhe RS-së".

"Jemi të kthyer nga Serbia, na pengon kufiri në Drinë dhe po punojmë që ai të mos ekzistojë", tha Dodik.

Në një paraqitje në podkastin "War Zone" të komentatorit politik amerikan, Wayne Allyn Root, Dodik më 25 shtator deklaroi se "të krishterët në BeH nuk duan më të jetojnë nën sundimin mysliman".

Për shkak të veprimeve që autoritetet amerikane i kanë cilësuar si kërcënim ndaj Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit dhe rendit kushtetues të Bosnjë e Hercegovinës, Dodik ishte për vite me radhë nën sanksione, të cilat iu hoqën në fund të tetorit të vitit të kaluar.

Duke paralajmëruar se ai ka vazhduar me retorikën separatiste, një grup dypartiak senatorësh dhe kongresistësh amerikanë kërkoi në mars nga administrata e Donald Trumpit që t'i rivendosë sanksionet.

Lidhjet mes RS-së dhe Serbisë

TE FUNDIT

🕒 Volejbolli/ Polonia pushton Europën, mund Francën dhe mbron titullin

🕒 7 herë kampion i Shqipërisë. Rrëfimi i Renato Arapit: Nga vështirësitë te trofetë

🕒 Vendimi për ish-krerët e UÇK, Kuvendi miraton deklaratën për Gjykatën Speciale

🕒 Çfarë vjen pas vendimit të Hagës? Rinia më e guximshme se elita politike e ajo intelektuale

MË TË VIZITUARAT

Skandali me SHISH, ekspertja kanadeze e sigurisë: Zbuloni nëse ka të bëjë me ...

Fier, zjarr i madh në Kreshpan. rrezikohet edhe masivi pyjor me pisha

Partitë pa marrëveshje për presidentin e ri teksa afati po përfundon

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Mesazhet për lidhje të forta mes entitetit RS dhe Serbisë, si dhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të tyre, janë të pranishme edhe në fushatat e partive të tjera në këtë entitet të BeH-së. Ato u theksuan edhe në mesin e shtatorit në Banjallukë, gjatë shënimit të Ditës së Unitetit Serb.

Drashko Stanivuković, kryetar i Banjallukës dhe kryetar i lëvizjes opozitare “Sigurna Srpska”, publikoi atëherë në rrjetet sociale një mesazh se “RS-ja dhe Serbia janë një” dhe se “bashkimi, uniteti dhe liria janë fjalë të shenjta serbe”.

Pas këtyre deklaratave reagoi Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (OHR), duke paralajmëruar se thirrjet për shkëputje, pavarësi ose bashkim me një shtet tjetër janë në kundërshtim me kornizën kushtetuese të BeH-së.

Nga Misioni në BeH i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) theksuan se retorika që vë në pikëpyetje ekzistencën e BeH-së ose të entiteteve të saj është në kundërshtim me Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit, me të cilën në vitin 1995 u ndal lufta në BeH.

Një pjesë e kandidatëve nga RS-ja e shfrytëzuan gjithashtu fushatën zgjedhore për të akuzuar politikanët nga entiteti tjetër, Federata e BeH-së, për “urrejtje ndaj serbëve”.

Kështu, Sërgjan Amidžhiq, ministri aktual i Financave i BeH-së dhe kandidat i SNSD-së së Dodikut për Dhomën e Përfaqësuesve të Parlamentit të BeH-së, më 20 shtator tha se “nuk e kishte ndier urrejtjen e vërtetë derisa filloi të punonte në Sarajevë”. Duke folur për politikanët nga Sarajeva, Amidžhiq tha se do t'i “çonte në kisha” që t'u shpjegohej “dallimi mes të mirës dhe të keqes”.

Deklarata të ngjashme, në të cilat ai akuzonte “Sarajevën politike” për urrejtje ndaj serbëve, Amidžhiq kishte bërë edhe më herët gjatë këtij viti, për shkak të të cilave janë ngritur kallëzime penale.

Mobilizimi i emocioneve

Adis Maksiq, profesor universitar që ka analizuar fushatën për zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në vitin 2022, thotë për Radion Evropa e Lirë (REL) se fushata e këtij viti në masë të madhe po përsërit modelet e asaj periudhe.

Në analizën e fushatës para katër vjetësh, ai kishte vënë në dukje se temat e identitetit, qëndrimit ndaj së kaluarës, fantazive të parealizuar të luftës dhe ndjenjës së padrejtësisë merrnin më shumë hapësirë sesa programet dhe politikat konkrete të partive. Përmes këtyre temave, partitë e paraqisnin grupin e tyre si viktimë dhe veten si ata që mund ta mbronin.

“Këto tema vazhdimisht dominojnë. Kjo nuk është befasuese për shkak se politikanët tanë, në masë të madhe, janë njerëz që nuk kanë shumë njohuri për qeverisjen dhe për çështjet konkrete të rëndësishme për administrimin dhe ndërtimin e shtetit. Por, ata e kanë përsosur aftësinë për të manipuluar dhe mobilizuar emocionet”, tha Maksiq për REL-in.

Vdekja e Mlladiqit, në momentin kur po niste fushata zgjedhore, i ka forcuar më tej këto narrativa, të cilat janë konstante në të gjitha zgjedhjet e pasluftës në BeH, thotë Maksiq.

“Ngjarjet pas vdekjes së Mlladiqit e ngritën intensitetin për një ose dy shkalet. Ajo u bë boshti rreth të cilit do të sillen këto rrëfime. Nga njëra anë, ata garonin se kush do të ishte në varrim, ndërsa nga ana tjetër garojnë në dënime dhe mesazhe: ‘Jini të gatshëm, jini të bashkuar’”, tha ai.

Duke theksuar se situata me glorifikimin e Mlladiqit në RS nuk lë hapësirë për relativizim dhe se pas ngjarjeve gjatë varrimit në Serbi është shtuar ndjenja e kërcënimit dhe nevoja për përgjigje, Maksiq thotë se problemi lind kur partitë politike përpiqen ta paraqesin veten si të vetmet që mund ta shpëtojnë vendin.

“Ajo që festohet në RS ka një dimension të rëndë, por sa i përket taktikave politike në përgjithësi, gjërat janë të ngjashme. Këtu kemi një riciklim të vazhdueshëm të ndjenjës së padrejtësisë nga e kaluara, e cila vazhdon në të tashmen dhe do të nënkuptojë një kërcënim në të ardhmen. Kjo thjesht hap hapësirë që ta paraqitësh veten si shpëtimtar”, tha ai.

Fushata në vargje

Me mesazhe për pogromin gjatë luftës dhe aparteidin pas luftës ndaj boshnjakëve, Partia e Venrimit Demokratik (SDA). partia më e madhe boshniake në BeH. e cila aktualisht është

në opozitë, e nisi fushatën në Stolac, në juglindje të vendit, i cili gjatë luftës ishte një nga vendet ku u persekutua dhe dëbua popullsia boshnjake.

Disa ditë më vonë, lideri i saj dhe kandidati për anëtar të Presidencës së BeH-së, Bakir Izetbegović, tha se “vetëm SDA-ja mund ta shpëtojë vendin”.

Mesazhet përmes të cilave partitë dhe kandidatët e paraqesin veten si ata që mund ta mbrojnë BeH-në dhe popullin e tyre nuk mbetën vetëm në fjalimet në tubimet parazgjedhore.

Partia politike “Snaga naroda” në fillim të fushatës publikoi këngën “Bosno moja”, ndërsa në videoklip shfaqen njëra pas tjetrës pamje të flamujve, xhamive, varrezave dhe pjesëve të ndryshme të vendit. Në video dominojnë kryetari i kësaj partie, Ramo Isak, dhe anëtarët e saj.

Ndërsa shfaqen pamje të marshimeve me flamuj, tubimeve familjare dhe lutjeve në xhami, në këngë përmenden vargje për “skifterët në mbrojtje” dhe dëshmorët, si dhe për tradhtarët që donin ta shisnin BeH-në.

Disa ditë më vonë, vëmendjen në rrjetet sociale e tërhoqi edhe një video ku shfaqet Haris Zahiragić, nënkryetar i SDA-së. Videoja, e krijuar me ndihmën e inteligjencës artificiale, e paraqet Zahiragićin duke fluturuar mbi një dragua, me flamurin me zambakë, dhe më pas duke luftuar kundër përbindëshave, ndërsa në fund ngul flamurin në një shkëmb.

Maksiriq thotë për REL-in se emocionet si shtysë e fushatave politike nuk janë specifike vetëm për BeH-në dhe kujton zgjedhjet në SHBA, por edhe fushatat evropiane, në të cilat vitet e fundit janë më të pranishme temat e identitetit dhe forma të ndryshme të ksenofobisë.

Sipas tij, BeH dallohet për trashëgiminë emocionale të luftës, e cila përbën një “rezervuar” të madh dhe lehtësisht të qasshëm për mesazhet politike.

“Ky intuitivitet ndaj votuesve, apo ajo që quhet ‘gut feeling’, mjafton që politikanët t’i përshtatin mesazhet politike me emocionet tek të cilat mund të llogarisin”, tha ai.

Përfaqësimi legjitim dhe entiteti i tretë

Ndërsa javët e para të fushatës zgjedhore në BeH u shënuan nga ngjarjet pas vdekjes dhe varrimit të Mladiqit, partitë që synojnë votat e elektoratit kroat vazhduan të insistojnë në barazinë politike dhe në atë që e quajnë përfaqësim legjitim të kroatëve në BeH.

Fushata solli edhe rihapjen e çështjes së riorganizimit territorial të BeH-së, përkatësisht entitetit të tretë, në një kohë kur nga Bashkimi Evropian vijnë mesazhe për nevojën e ruajtjes së rendit kushtetues ekzistues të BeH-së.

Kryetari i Lëvizjes Kombëtare Kroate (HNP), parti politike me seli në Livno, u shfaq në një pllakat me mesazhin: “HNP-ja është për të tretin, po ju?”

Vukadin edhe në vitet e mëparshme kishte theksuar se entiteti i tretë për popullin kroat në BeH është synim i veprimit politik të partisë së tij dhe kishte mbështetur modelin “tre popuj, tre entitete”.

Në prag të fillimit të fushatës zgjedhore në BeH, Parlamenti i Kroacisë miratoi një rezolutë që mbështet ndryshimet në sistemin zgjedhor për të siguruar “përfaqësim legjitim politik” të kroatëve në BeH.

Rezoluta u miratua me iniciativën e Lëvizjes Atdheu (Domovinski pokret), parti e së djathtës radikale në Kroaci, e cila kishte argumentuar se, nëse nuk arrihet marrëveshje, duhet të shqyrtohet rikthimi i Herceg-Bosnjës, projektit politik të shfuqizuar me Marrëveshjen e Uashingtonit në vitin 1994.

Për debatet rreth entitetit të tretë kishte paralajmëruar në maj edhe ish-Përfaqësuesi i Lartë Christian Schmidt, në raportin për situatën në BeH që ia dorëzoi Kombeve të Bashkuara.

Schmidt theksoi se ky debat tregoi ndjeshmërinë e sulmeve ndaj rendit kushtetues të BeH-së dhe përpjekjeve për ta “ndarë më tej vendin përgjatë vijave etnike”.

Mesazhet për nevojën e unitetit kombëtar kandidatët ua dërguan votuesve gjatë shënimit të përvjetorëve të betejave të luftës dhe themelimit të brigadave të kohës së luftës, ku

folën për rëndësinë e bashkimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar.

Kështu, kandidatja e Partisë Demokratike Kroate (HDZ) për anëtare të Presidencës së BeH-së, Darijana Filipović, e nisi fushatën në Ravno, një vend në Hercegovinë që ishte ndër të parët që u shkatërruan gjatë sulmit të Ushtrisë Popullore Jugosllave në vitin 1991, duke thënë se ky është “një vend që e di mirë se sa mund të kushtojë liria”.

Edhe pse çështja e formimit të entitetit të tretë nuk dominon në fushatën e saj, Filipović kishte folur për këtë çështje disa muaj para fillimit zyrtar të fushatës, kur në paraqitjet e saj në media kishte theksuar se “entiteti i tretë mbetet një nga modelet ose mundësitë për t’u shqyrtuar”.

Zgjedhjet e përgjithshme në BeH do të mbahen më 4 tetor, kur rreth 3.4 milionë votues të regjistruar do të zgjedhin anëtarët e Presidencës së BeH-së, deputetët në parlamentet shtetërore dhe të entiteteve, presidentin dhe zëvendëspresidentët e entitetit RS, si dhe deputetët në kuvendet kantonale./ [REL](#) (A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**



MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Serbia, vend me të kaluar të dhunshme!” CNN “mbërthen” Vuçiç për Mlladiçin dhe luftërat para dorëheqjes



Vuçiç jep dorëheqjen si President: I shërbeva me besnikëri vendit, krenar që nuk nxita urrejtje!



Aleksandar Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë



Dorëhiqet Vuçiç: Nder i madh të isha president, do t’i kujtoni këto vite...!





Alarm për eksplozivë pranë bazës RAF Fairford në Mbretërinë e Bashkuar, evakuohet fshati



Sulm me armë në një kafene në Athinë, plagoset 10-vjeçarja shqiptare

Latest Videos



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.